[Shqiptarja.com]
E martë 28 Qershor 2022 - Përditësimi i fundit 21:46

POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1 Del VIDEO e re nga aksidenti tragjik në Berat/ E reja ishte në parakalim, devijoi për të shmangur kamionin, por përfundoi në lumë

2 Bombë me telekomandë makinës së drejtoreshës së Shëndetit Publik në Shkodër, do të shpërthente kur zyrtarja të futej në mjet

3 Aksidenti tragjik në Osum, përcillen në banesën e fundit 25-vjeçarja dhe i biri! Flet fqinja: Ende nuk e besoj që kanë vdekur, u tronditëm shumë

4 Emrat/ Fëmijët e gjyqtarëve të shkarkuar nga Vetingu pranohen në Shkollën e Magjistraturës për t'u bërë prokurorë dhe gjyqtarë të rinj

5 U arrestua sot, kush është Albert Nushi, ish zv.drejtor i Policisë, ishte në vendngjarje kur u vra Pjerin Xhuvani, i përfshirë dhe në dosjen 'Babale'

Kronikë

Bombë me telekomandë në makinën e drejtoreshës së Operatorit të Kujdesit Shëndetësor në Shkodër, bëhet shpërthim i komanduar! Autori me motor hodhi lëndën plasëse (VIDEO)

Një sasi tritoli është vendosur në gomën e parë të një makinë në afërsi të Drejtorisë së Shëndetit Publik në Shkodër, konkretisht në makinën e drejtoreshës së këtij institucioni Suida Kuka. Lënda eksplozive ka qenë me telekomandë, ndërsa dyshohet se lënda plasëse do të shpëthente sapo Kuka të futej në makinë

- Tritoli në makinë lidhet me detyrën? Ja kompetencat e drejtoreshës se OSHKSH në Shkodër
- Eksploziv pranë mjetit të saj, kush është drejtoresha e Operatorit të Kujdesit Shëndetësor në Shkodër, mori detyrën pak muaj më parë

Redaksia
28 Qershor, 18:50 | **Përditesimi i fundit: 28 Qershor, 21:46**

SHKODËR- Suida Kuka, drejtoreshë e Operatorit të Kujdesit Shëndetësor në Shkodër, i ka shpëtuar mrekullisht një atentati të organizuar kundrejt saj, pasi i kishin vendosur eksploziv me telekomandë në gomën e parë të makinës, i cili do të shpërthente sapo ajo të futej në mjet.

Ngjarja ka ndodhur rreth orës 16:00 në lagjen Vojo Kushi, dhe dyshohet se sasia e lëndës eksplozive, sasia e të cilës ishte rreth 200 gramë tritol, u hodh në gomën e parë të makinës së saj tip 'Range Rover', nga një person, i cili po udhëtonte me motor.


LEXO EDHE:
Sherr me xhaxhain për pronat! Arrestohet 29-vjeçari në Malësi të Madhe, e kërcënoi duke qëlluar në ajër me automatik

Gazetari i Report Tv, Ergys Kavaja bën me dije se ishte vetë Suida Kuka, që ka konstatuar pakon e çuditshme, e cila ishte mbështjellë me një letër të verdhë dhe të kuqe dhe ka njoftuar menjëherë policinë. Policia ka bërë rrethimin e zonës dhe evakuimin e banorëve. Lënda plasëse, më pas është shpërthyer nga forcat xheniere, të cilat kanë kryer shpërthimin e telekomanduar.

Mbetet mister qëllimi i vendosjes së eksplozivit. Burime për Report Tv bëjnë me dije se Suida Kuka në dëshminë e dhënë në polici ka deklaruar se nuk ka konflikte me persona të tjerë dhe se nuk ka marrë kërcënime në lidhje me detyrën apo me jetën e saj personale.

Suida Kuka nuk ka një angazhim të gjatë në jetën aktive politike në Shkodër. Kuka, më parë ka mbajtur pozicionin si drejtore e Njësisë Vendor e Kujdesit Shëndetësor në Shkodër dhe në muajin maj ishte emëruar drejtore e Operatorit të Kujdesit Shëndetësor për rajonin Verior, post që më herët e ka mbajtur Astrit Beci.

Drejtoria rajonale e Shkodrës e operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, të cilën drejton Kuka, ka nën varësinë të saj njësitë e ofrimit direkt të shërbimeve, të cilat përfshijnë njësitë vendore të kujdesit shëndetësor, qendrat shëndetësore, klinikat dhe institucionet shëndetësore me shtretër, spitalet.

Kompetencat e Suida Kukës

Planifikojnë nevojat për shërbime të kujdesit shëndetësor në nivel rajoni;
b) Garantojnë që shërbimet shëndetësore të ofrohen brenda standardeve, në kohë, brenda buxhetit dhe në cilësinë e kërkuar, në territorin që mbulojnë;
c) Koordinojnë, monitorojnë dhe sigurojnë ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor në nivel rajoni, pranë vendbanimit, për të gjithë qytetarët;
ç) Kryejnë procedurat për menaxhimin e burimeve njerëzore në sistemin shëndetësor parësor, shëndetin publik dhe spitalor (planifikimi i nevojave, rekrutimi, trajnimi etj.) për rajonin përkatës;
d) Bashkëpunojnë me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) për çështje të lidhura me financimin e kujdesit shëndetësor;
dh) Bashkërendojnë punën ndërmjet të gjitha strukturave që kanë në varësi.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 21:18

Bombë me telekomandë makinës së drejtoreshës së Shëndetit Publik në Shkodër, do të shpërthente kur zyrtarja të futej në mjet



Lënda plasëse e vendosur në makinën e drejtoreshës së Operatorit të Kujdesit Shëndetësor në Shkodër, Suida Kukës, ishte eksploziv me telekomandë, thonë burime për Report Tv, nga grupi i forcave xheniere. Dyshohet se lënda plasëse do të shpërthente gjatë kohës që drejtoresha mund të hipte në makinë. Dyshohet se lënda shpërthyese ishte në sasinë 200 gramë.

Askush nuk e mori seriozisht atë që po ndodhte, pasi lënda plasëse ka qenë e mbështjellë me një letër moltoje, ngjyrë e bardhë dhe e kuqe. Sakaq mbetet mister qëllimi i vendosjes së eksplozivit.

Suida Kuka ka dhënë dëshminë dhe ka deklaruar se nuk ka konflikte me persona të tjerë, ndërsa nuk ka marrë kërcënime në lidhje me detyrën apo me jetën e saj personale.

Ora 21:01

Lënda plasëse në makinën e drejtoreshës së Shëndetit Publik, momenti pak pas shpërthimit të eksplozivit nga forcat xheniere në Shkodër (VIDEO)

Kanë dalë pamjet pak pas shpërthimit të kontrolluar të kryer nga forcat xheniere të lëndës plasëse të vendosur në makinën e drejtoreshës së Operatorit të Kujdesit Shëndetësor në Shkodër, Suida Kukës.

Ora 19:57

Dalin pamjet, ja ku ishte vendosur eksplozivi në makinën e drejtoreshës së Shëndetit Publik në Shkodër



Lënda plasëse në makinën e Suida Kukës, drejtoreshë e Operatorit të Kujdesit Shëndetësor në Shkodër ishte vendosur nën gomën e parë të makinës 'Range Rover'. Siç shihet edhe nga pamjet e siguruara nga Report Tv, ajo është mbështjellë me një letër të verdhë dhe të kuqe. Ka qenë vetë Kuko që ka konstatuar pakon e lëndës plasëse dhe ka njoftuar policinë.

Ora 18:56

Eksploziv pranë mjetit të saj, kush është drejtoresha e Operatorit të Kujdesit Shëndetësor në Shkodër, mori detyrën pak muaj më parë



Suida Kuka është drejtoresha e Operatorit të Shërbimit Shëndetësor në Shkodër, që iu vu eksplozivi. Ajo mori detyrën në 16 maj 2022.

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: Shkoder Suida Kuka eksploziv policia e shtetit

Komento

Komente

Pun shakash: 28/06/2022 21:32
Dashnore burrash te martum e ven drejtoresh e ban namin tu ju marr njerzve lek . Ku e mori ate makin 30 mij euro ??? Po e ka vu vet kjo se ka ba lek boll e don me ik jashtetit me ju shkeput dhe burrave te martum
Përgjigju

Parrucjani: 28/06/2022 20:00
E paska vendos vet, ka dal ne mode tritoli per kerkese azili politik. U mor vesh kjo loj.
Përgjigju

Gjyshi: 28/06/2022 19:49
Nuk ka angazhim te gjate ne politike por paska Range Rover..........Keta " pasaniket" e rinj vdesin te behen pak drejtora ne administrate shteterore....rezultati....."nuk ka" konflikte personale.......
Përgjigju

Plera: 28/06/2022 19:48
E ka vu vete o idiota, pse beni sikur s'kuptoni!!! Drejtoreshe 29 vjeç para 1 muaji u vu drejtoreshe Dashnorja e filanit.. e njeh mire tan shkodra. Dhe don azil per letra. Shkoi ajo e pa te makina dicka te pa zakonte!!! Kush eshte ai qe shkon te makina dhe e kontrollon Makinen per bombe, pervec atyre qe kane hasmeri.. Kjo e kontrolloka makinen sipas ksaj ! Sa per info, ai qe te ve bomben, nuk te jep shume kohe ta gjesh, Dhe nuk ta ve te rrota Por ta ve mire dhe nuk pret ta plasi renea. Respekt
Përgjigju

> **Filani:** 28/06/2022 20:15
> Dashnorja e kujt esht kjo

ymeri: 28/06/2022 19:38
C'FARE KENI ME MAKINAT MOR QELBESIRA,,,,C'FAJ TE KA MAKINA MOR SHKERDHATE....
Përgjigju

> **Shkodrani:** 28/06/2022 19:56
> Shko e hiqja ti tritolin me dore qe ta shpetosh makinen pa u demtu.

Toni: 28/06/2022 19:37
Si ka mundesi te gjithe keta drejtore apo drejtoresha me Range Rovera? Shteti legen qe ka krijuar Rama. Kokat e njeri thetrit do hane.
Përgjigju

aldo: 28/06/2022 19:32
pak a shume si pensionistja tasha ne durres, ose klea
Përgjigju

Dori: 28/06/2022 19:10
Akte mafioze te denja per nje shtet mafioz
Përgjigju

Popull: 28/06/2022 19:04
Bythqirat e shkodres merren me femrat.
Përgjigju

> **Populli:** 28/06/2022 19:49
> Ta qifte populli i shkodres nanen e motre dhe ndonje gje Ca ke aty rrotull..

> **Popull kurve:** 28/06/2022 19:11
> E kengrua apo incest

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A duhet të miratohet ligji për amnistinë fiskale deri në 2 milionë euro?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

Kronikë

Zbulohen 2 parcela me 350 rrënjë kanabis në Shkodër, 2 kultivuesit i shpëtojnë policisë
24 Qershor, 10:07

Sociale

'Një natë shkodrane' në shtëpinë e të moshuarve
Besmira Xhaferasi
23 Qershor, 20:35

Kronikë

Shkodër/ Përplasi për vdekje 31-vjeçaren, arrestohet drejtuesi i mjetit (VIDEO)
23 Qershor, 09:42

Kronikë

Errësira vret në Shkodër! Makina përplas biçikletën, vdes gruaja! Viktima ende e paidentifikuar (VIDEO)
22 Qershor, 22:25

Kronikë

Shkodër/ Kishin kthyer lokalin në qendër lojërash fati, 2 në pranga dhe 9 të tjerë në hetim
22 Qershor, 13:30

Kronikë

Emërohen 12 nënkomisarë të rinj në Policinë e Shkodrës, Gledis Nano: Kanabisi është një sfidë e madhe, sepse prej kësaj veprimtarie fuqizohen grupet kriminale
20 Qershor, 18:35

Kronikë

Shkodër/ Po transportonte 2 emigrantë të paligjshëm pakistanez, arrestohet 58-vjeçari
20 Qershor, 16:41

Kronikë

Shkodër - Finalizohet operacioni policor antikanabis i koduar "Vallas"
Shkodër, sekuestrohen 246 kg kanabis në fshatin Vallas, 6 në pranga dhe 8 të tjerë në kërkim (VIDEO)
20 Qershor, 10:48

Kronikë

Harta gjyqësore/ Dhoma e Avokatisë Lezhë dhe Gjirokastër do të vijojë bojkotin gjatë javës së ardhshme, thirrja për protestë në 3 qytete
19 Qershor, 16:34

Kronikë

Trafik i rënduar në autostradën Durrës-Tiranë, apeli i policisë: Përdorni rrugët alternative, ka fluks të madh automjetesh
19 Qershor, 16:20

Kronikë

Ekskluzive/ Çadra kampingu dhe vaditje me pika uji në rrënjët e kanabisit, FOTO nga parcelat në Velipojë! Nano-vartësve: Kush fsheh drogën përjashtohet
Arsen Rusta
19 Qershor, 11:47

Kronikë

Ranë nga lartësia duke eksploruar natyrë, evakuohen 2 turistë të dëmtuar rëndë në 'Syrin e Ciklopit'
18 Qershor, 20:50

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje